**VENDIM**
**Nr. 423, datë 28.5.2020**

# PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.305,DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT AKTUALË DHE PUNONJËSIT E LARGUAR NGA PUNA SI PASOJË E COVID-19"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Dhënie ndihme financiare, prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh, për ish-të punësuarit në subjektet që janë lejuar të kryejnë aktivitetet ose janë mbyllur sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data 1 mars 2020 deri në datën 17 maj 2020.".

2. Në fund të pikës 2, të kreut II, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

"Në rastet e mosaplikimit nga ana e subjektit, ndihma financiare për të punësuarit apo ish-të punësuarit do të jepet menjëherë pas miratimit nga administrata tatimore. Miratimi kryhet pas verifikimit të kritereve bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënave që të punësuarit apo ish-të punësuarit do të dorëzojnë.

Të dhënat që do të dorëzohen janë të njëjta me ato të parashikuara në pikën 6, të këtij kreu. Afati për dorëzimin e këtyre të dhënave është deri në datën 5 qershor 2020.".

3. Pika 5, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Për të përfituar nga ndihma financiare duhet që punonjësi të ketë qenë në marrëdhënie pune, sipas përcaktimeve në kreun I, të këtij vendimi.".

4. Në fund të pikës 6, të kreut III, shtohen fjalët "... si dhe rregullat dhe hapat proceduralë që do të ndiqen për zbatimin e paragrafit të dytë, të pikës 2, të kreut II.".

5. Në fund të pikës 2, të kreut IV, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

"Të punësuarit apo të ish-punësuarit, të cilët përfitojnë ndihmën financiare sipas këtij vendimi, përjashtohen nga përfitimi njëkohësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore të pagesës së ndihmës ekonomike si dhe të pagesës të së ardhurës nga papunësia, mbështetur në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, sipas të cilit nuk lejohet përfitimi në të njëjtën kohë nga dy skema të mbështetjes shtetërore.

Për të gjithë aplikuesit për pagesë papunësie, të cilët kanë plotësuar dosjen brenda kritereve ligjore dhe kanë fituar statusin e përfituesit të pagesës së papunësisë, nuk humbet e drejta për përfitim të pagesës së papunësisë, por lëvrimi i pagesës së papunësisë do të fillojë pas mbarimit të skemës sipas këtij vendimi, nëse do të jenë ende të papunë.".

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**